



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISE  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1489 Prot.  
12.2

Patos, më 15.07.2022

**PROCES-VERBAL**

I mbajtur sot në datë 15.07.2022 ora 11:00, në ambientet e godinës së kopshtit të fëmijëve në fshati Verbas, Njësia Administrative Zharrëz ku zhvillohet takimi informues **me temë:** “Rikonstruksion dhe adaptim i kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore”, prishja e godinës pranë fushës sportive verbas që funksionon si qendër shëndetësore

Pjesëmarrës në këtë dëgjesë publike:

1. Kryetar i fshati Verbas
2. Banorë kufitarë me godinën kopshti i fëmijëve fshati Verbas
3. Koordinator i Konsultimit Publik
4. Përfaqësue të Bshkisë Patos
5. Administratore e Njësisë

Takimi hapet nga Administatore e Njësisë znj. Polikseni Tupe

Polikseni Tupe – në datë 06.07.2022 ne kemi realizuar një dëgjesë publike me banorë të fshatit Verbas lidhur mbi rikonstruksruksionin e godinës së kopshtit për ta kthyer në një qendër të mirfilltë ambulatore. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të Drejtorisë së Shëndetit publik Fier dhe Drejtorisë Rajonale Vlorë, të cilët kanë kërkuar realizimin e një takimi informues vetëm me banorët të cilët janë kufitarë me këtë godinë. Për më tepër Ddrejtori i projekteve në bashki do t'ju informojë

Arben Manoku – faleminderit. Sic e tha edhe znj Polikseni ky takim i sotëm ka për qëllim informimin tuaj lidhur mbi prejektin për rehabilitimin e kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore dhe prishjen e godinës pranë fushës sportive në fshat e cila aktualisht funksionin si qendër shëndetësore. Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni i kësaj godine që sic dhe e dimë është totalisht jashtë funksionit të tij për shkak të amortizimit të tij. Ajo që ne synojmë është kthimi i kësaj godine në një qendër ambulatore të mirëfilltë me dy dhoma shërbimi dhe tualet pasi godina aktuale që shërben si ambulancë kështë në një kapacitet më të vogël dhe struktura e saj nuk të oforon mundësinë përmarrjen e një shërbimi cilësor. Pas transferimit të shërbimeve në ambientet e reja, edhe fusha e sportit do ti nënshtronhet rikonstruksionit të ambienteve të saj dhe për

rrjedhojë lind nevoja për prishjen e godinës ekzistuese. Ky është një investim i cili do të kryhet nga fondet e Bashkisë Patos. Nëse keni pyetje apo komente unë jam i hapur t'ju përgjigjem cdo pyetje.

Admir Azizaj – qendra shëndetësore duhet të jetë sa më afër banesave

Arben Manoku – ndaj dhe ne kemi menduar të bëjmë këtë investim duke e kthyer godinën e kopshtit në një qendër shëndetësore duke qenë se ashte puthuajse në mes të fshatit tuaj,

Vasilika Kola – do të bëhet riparimi i soletës? Pasi ajo është totalisht shumë e dëmtuar

Arben Manoku – padiskutim që po pasi godina do ti nënshtronhet një rikonstruksion total

Bulë Hazizaj- kërkoj që të vendosen edhe stola ne oborrin e godines pasi ka hapesirë të mjaftueshme edhe për vendsjen e stolave edhe për mbjelljen e pemëve.

Fatmir Mucaj – po për ujrat e zeza si do të veprohet?

Arben Manoku – është menduar dheprojektuar që të funksionojmë me gropë septike pasi sic e dimë fshatit nuk ka infrastrukturë KUZ-se dhe kjo do të jetë deri në një moment të dytë derisane të ndërhykmë për të patur një rrjet të mirfilltë jo vetëm për qendrën shëndetësore por për të gjithë fshatin

Vasil Kola – unë sic e shikoni jam invalid dhe dua të kem amulancë dhe doktor pasi e kam të vështirë levizjen për të kaluar rrugën dhe për të vajtur deri te ambulanca aktuale që është një dhomë e vogël. Ndaj nëse do të ishte e mundur të bënët dy dhoma dhe të vendosni stola ku të ulemi

Arben Manoku – struktura e godinës aktuale na jep mundësine për sistemimin e dy dhomave të shërbimit ku padiskutim do të ketë edhe ambiente pritëse për pacientët. Nuk e do nëse ka ndonjë keresë tjetër psi ky është një takim informues ku bashkia përkon të jetë sa më transparent me qytetaaret e saj.

Arben Manoku – pikërisht ky është edhe qëllimi i këtij investimi, ofrimi i shërbimeve më cilësore për komunitetin

Plikseni Tupe – ndonjë pyetje tjetër? Mqse jo atëherë ky takim konsiderohet i mbyllur.

**Konceptoi:**

**Koordinator Konsultimin Publik**  
Suzana Hysenaj



**Sekretar Këshilli**  
Balil Balili



Adresa: Lagja "Nafiqetari", Rruga "Unaza", Patos